



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

**Nr. K3/SH35 – 5 Prot.
Nr. Dok. 202201311/5**

Tiranë 15/10/2024

Lënda: Kërkesë për plotësimin e detyrimit ligjor për dhënien e shpjegimeve Avokatit të Popullit si dhe fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë.

DREJTORISË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS

VLORE

**Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AGJENCISË SHTETËRORE TË
KADASTRËS**

TIRANË

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka marrë në administrim ankesën drejtuar Avokatit të Popullit nga shtetasja Sh.Z.

Në ankesë e saj, znj. Sh.Z. ankohet për mosveprim të Drejtorisë Vendore të Agjencisë së Kadastrës Shtetërore Vlorë (DVASHK Vlorë), në lidhje me ecurinë e procesit të legalizimit të një objekti informal me funksion banimi dhe të truallit të tij funksional që ndodhet në lagjen "Pavarësia", Zona Kadastrale 8604, të vetëdeklaruar prej saj për legalizim me aplikimin nr.2552/4 prot., datë 14.08.2006, dhe për mospajisje ende me titull pronësie.

Ankuesja ka bashkëlidhur ankesës edhe dokumentacionin provues që vërteton vetëdeklarimin që ka bërë në qershor të vitit 2021 dhe shkresën e ASHK-së Vlorë nr. 10367 prot., datë 23.06.2021, "Kërkesë për afishim publik", me anë të së cilës i është drejtuar Bashkisë Vlorë për afishim të

listës emërore për një periudhë 30 ditore të listës, nga ku rezulton që znj. Sh.Z. dhe bashkëshorti i saj janë listuar me numër rendor 1. Sh.Z., F.Z. (bashkëshorti).

Sikundër ankuesja shkruan, megjithëse i është dërguar “Kërkesa për afishim publik” Bashkisë Vlorë, pas kalimit të afatit 30 ditor të afishimit, ankuesja nuk është pajisur me titullin e pronësisë për objektin 1 kat, banim, sipërfaqe 49 m², dhe sipërfaqe trualli funksionale 143 m², edhe pse ka ndjekur të gjitha hapat sipas përcaktimeve ligjore që dosja e saj të ishte e plotë.

Në këto rrethana, ankuesja ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, për zgjidhjen e kësaj çështjeje si dhe marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) si dhe DVASHK-ja Vlorë, lidhur me përfundimin e procedurave për pajisjen me certifikatë pronësie për objektin informal si dhe truallin funksional të këtij objekti.

Sa më sipër, pas marrjes dijeni për kërkesën ankimore kemi vendosur marrjen në shqyrtim të saj, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 13¹, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kjo pasi, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se ankesa e paraqitur plotëson të gjitha kushtet thelbësore si në aspektin formal, ashtu edhe në aspektin substancial për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor dhe konkretisht, nenit 63, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionit e kërkuara prej tij*”, si dhe nenit 19, gërma b), të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*”, në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e rrethanave, i jemi drejtuar me disa shkresa organit tuaj publik, por ende nuk kemi marrë shpjegimet përkatëse për këtë çështje.

Më konkretisht, për sqarimin e kësaj ankese kemi kërkuar nga ana juaj me shkresën tonë nr. K3/SH35 – 2 prot., datë 09.12.2022, të na dërgohen shpjegime të detajuara lidhur me trajtimin e kësaj çështjeje, në referencë të pretendimeve të ngritura nga ana e znj. Sh.Z..

Në mungesë të përgjigjes suaj të pritshme brenda afateve ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, jemi detyruar të përsërisim këtë kërkesë me tjetër shkresë nr. K3/SH35 – 3 Prot., datë 12.04.2023. Përsëri sot e kësaj dite nuk kemi asnjë informacion të kërkuar, duke krijuar kështu një situatë të pazakontë, e cila ka ndikuar në afatet e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga ana e institucionit tonë.

Po ashtu, në datë 10.06.2024 jemi informuar nga ankuesja se situata për të cilën ankohet nuk ka gjetur zgjidhje deri më sot. Për këtë ju jemi ridrejtuar me shkresën K3/SH35 – 4 prot., datë 01.07.2024 “Kërkesë e përsëritur për shpjegime”. Pavarësisht kësaj, vazhdon moskthimi i përgjigjeve nga ana juaj ndaj komunikimit shkresor disa vjeçar i kërkuar nga institucioni i Avokatit të Popullit.

¹ Neni 13 i ligjit nr 8454, datë 04.02.1999 ‘Për Avokatin e Popullit’, i ndryshuar parashikon se: “*Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike*”. Kjo pasi, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se ankesa e paraqitur plotëson të gjitha kushtet thelbësore si në aspektin formal, ashtu edhe në aspektin substancial për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore

Efektivisht sot, pas më shumë se një vit, vazhdimi i shqyrtimit të kësaj çështjeje nga ana e Avokatit të Popullit është pamundësuar nga mungesa e gatishmërisë dhe e bashkëpunimit prej personave përgjegjës të DVASHK Vlorë, për dhënien e shpjegimeve të kërkuara.

Në rrethanat e parashtruara sa më sipër ju bëjmë me dije se, organi juaj publik e më konkretisht personat përgjegjës në DVASHK Vlorë, gjenden në shkelje flagrante të Kodit të Procedurave Administrative, duke mos zbatuar dhe cenuar rëndë parimin e respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Mosdërgimi i shpjegimeve të kërkuara ka sjellë si pasojë, mostrajtimin e kësaj ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e korrektesës së institucionit tonë ndaj ankueses. Ky qëndrim i mbajtur nga personat përgjegjës, punonjës në DVASHK Vlorë, ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit, për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme.

Ndërkohë, kjo sjellje cenon rëndë marrëdhëniet tona institucionale si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit, në publik. Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63² të saj, e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publik, për bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion.

Parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime. Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentat ligjore që Kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut, apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publikë. Neni 63, pika 1, 2 dhe 3 e Kushtetutës, parashikojnë instrumenta të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raporte vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet, apo propozimin për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës.

Gjithashtu, ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e institucionit tonë për të kërkuar fillimin e procedurës administrative për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike, apo nëpunësve të tyre. Në mënyrë eksplicite kjo është sanksionuar në nenin 22 të këtij ligji, në të cilin është parashikuar se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.”*

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurave Administrative, ashtu edhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”. Në nenin 3, të këtij ligji parashikohet se: *“Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë*

² Neni 63, parashikon se:

“1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit.

2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme.

3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publike, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe organet e institucionet e pavaruara, për arritjet e objektivave ligjore që u janë besuar, në përputhje me ligjin.”.

Duhet theksuar se, Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol “kontrollues” mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t’u krijohen shanse të barabarta.

Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në trajtimin e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, të pasakta, apo tek afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushteutese për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore ndërkohë që, të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta theksojmë se, detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit, gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ është një detyrim kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik.

Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të afateve dhe rrethanave të çështjes.

; efikasitet dhe efektivitet, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike, sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Në rrethanat e parashtruara sa më sipër, në rast se edhe pas këtij rekomandimi nuk mundësohet marrja e masave të nevojshme organizative për bashkëpunimin, bashkërendimin dhe bashkëveprimin e punës me institucionin e Avokatit të Popullit, me qëllim kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave të dërguara nga institucioni ynë, ju bëjmë me dije se nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, do të paraqiten materialet përkatëse në Prokurorinë pranë Gjykatës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, në përputhje me nenin 248, të Kodit Penal për “Shpërdorim detyrë”, pasi vlerësojmë se DVASHK Vlorë është përgjegjëse për mosveprim, apo për mungesën e dhënies së përgjigjeve përkatëse.

Referuar problematikës së hasur në këtë rast, me personat përgjegjës në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, titullari i këtij organi publik, të vlerësojë në përputhje me ligjin organik dhe Kodin e Procedurave Administrative, veprimtarinë e personave përgjegjës mbi respektimin e afateve procedurale në shqyrtim të akteve si dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me legjislacionin aktual.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22, pika 1, të ligjit 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose Autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga Autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose shërbimi civil”*,

R E K O M A N D O J M Ë

1. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.
2. Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës, të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, lidhur me mospërbushjen e detyrimit ligjor, për t’i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.
3. Marrjen e masave për përfundimin e shqyrtimit të aplikimit të shtetasve Sh. Z., F. Z. (bashkëshorti).
4. Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI

d.v